



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivered	15.04.2021	1	viti god year
Organ / Rjeshtja Organ / Rjeshtja Org / Rshut	Nr / Pret Nr / Pret Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBESHAK	18/10/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr. 125/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani–kryetar Malsore Gashi dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, si dhe Rushit Kajtazi –Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar e ankesën Anr. 125/2021, të datës 05.03.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga „Zagrebi“, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në çështjen juridike “ **Vlerësim i punës** ”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa . Nr. 125/2021, e datës 05.03.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 09.02.2021 për ankuesin

III. DETYROHET, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit, Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë, i ankuesit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 05.03.2021, me numër protokolli 1013/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2020, të vlerësuar nga Udhëheqësi i Sektorit të Sigurisë- së TI, më arsyetim se vlerësimi vjetor, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 08.03.2021, me numër protokolli 1043/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 15.03.2021 me numër protokolli 1128/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.125/2021 e datës 05.03.2021, me numër protokolli 1013/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Përshkrimi i detyrave të punës; Përgjigje në ankesë e datës 15.03.2021, me numër protokolli 1128/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se vlerësimi vjetor i punës për vitin 2020, është bërë nga Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë- së TI-së në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në vlerësimin e rezultateve në vlerësim vjetor për ankuesin Kolegji konstaton se ankuesi është vlerësuar nga Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë- së TI-së, me notën e përgjithshme dy pikë (2.8) prandaj bazuar në vlerësimi vjetor i bërë nga Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë- së TI-së, del se vlerësimin është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse formulari i vlerësimit të punës është nënshkruar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt me datë 09.02.2021 e që është jashtë afatit ligjor të parapara me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar legjislacionin në fuqi, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se deri me datë 06.10.2020, kriteret dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil kanë qenë të përcaktuara me Rregulloren Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, ku sipas dispozitave të kësaj rregullore, vlerësimi i rezultateve të punës bazohet në matjen e realizimit të objektivave dhe aftësive të nëpunësit civil, sipas planit individual vjetor të punës dhe përshkrimit të detyrave të punës se tij.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu ka gjetur se vlerësimi i rezultateve të punës për ankuesin është bërë me datë 09.02.2021, në kundërshtim me afatin e përcaktuar me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, e cila rregullore ka hyrë në fuqi me datë 06.10.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, se organi i punësimit Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, pas pranimit të vendimit të Këshillit, është i obliguar që të beje rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës, anulimin e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2020 për ankuesin dhe kthimin e lëndës në rivlerësim të udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit.



Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë- së TI-së, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me rastin e rivlerësimit obligohet që të marr parasysh të gjeturat dhe të veproje sipas pikëpamjeve juridike të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi. Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 125/2021


Ruslita BAJTAZI
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme ;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

